



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 105 prot.

Tiranë, më 16.02. 2023

Lënda: Relacion mbi raportet e monitorimit për 12-mujorin e vitit 2022

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT**  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë për vitin 2022. Zbatimi i këtij buxheti është bazuar në drejtimet kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik, si dhe në parimin e ligjshmërisë, ekonomikitetit, efikasitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore.

Në vijim paraqitet, në mënyrë të përmbledhur, realizimi i fondeve buxhetore për këtë periudhë, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

**Në mijë lekë**

Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
Shpenzime korente	73,728	76,235	76,235	100 %
Shpenzime kapitale	2,000	600	432	72%
<b>TOTALI</b>	<b>75,728</b>	<b>76,835</b>	<b>76,667</b>	<b>99,8 %</b>

Me ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, u miratua buxheti total vjetor për Institucionin e Komisionerëve Publikë në vlerën 75,728 lekë, i ndarë në 73,728 mijë lekë, në shpenzime korente dhe 2,000 mijë lekë, në shpenzime kapitale.

Buxheti i miratuar për vitin 2022, në zërat e shpenzimeve korente, përputhej me kërkesën e paraqitur nga institucioni, në dokumentin e Projektbuxhetit Afatmesëm 2022-2024, ndërkohë që buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) ishte më i madh se nevojat. Gjatë vitit, ky buxhet ka pësuar ndryshime me akte normative, si dhe me rialokime brenda shpenzimeve korente, të cilat do të analizohen në vijim. Buxheti i rishikuar arriti në 76,835 mijë lekë, duke u rritur shpenzimet korente në 76,235 mijë lekë dhe pakësuar shpenzimet kapitale në 600 mijë lekë.

Me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.3.2022, të Këshillit të Ministrave, ky buxhet u pakësua në shpenzime korente, duke sjellë një efekt negativ në plotësimin e nevojave të institucionit në fushën e pagave, problematikë e cila iu parashtrua Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në muajin maj 2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Vendimin nr. 37/2022, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, në të cilin u miratua një shtesë mujore për natyrë të veçantë pune, për Njësinë Administrative, u bë një riklasifikim i pagave për disa nga pozicionet e punës të kësaj njësie, si dhe u përcaktua masa dhe kufiri maksimal i pagesave shtesë për shkak të vështirësisë, për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor.


Me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave, nr. 12, datë 29.7.2022, u pakësuan fondet në investime në vlerë 1,400 mijë lekë dhe u shtua me 3,400 mijë lekë buxheti në shpenzime personeli, për të mbuluar efektin financiar të rritjes së pagave. Pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 621, datë 28.9.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike’ ”, të ndryshuar, për të mbuluar efektin financiar në shpenzime personeli, për periudhën e mbetur të vitit, u alokua buxhet shtesë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në mënyrë analitike, performancën e realizimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2022, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, e gjeni të paraqitur në formë tabelore dhe grafike, si më poshtë:

### Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë

Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	66,128	70,575	70,575	100%
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime dhe transferta	7,600	5,660	5,659	100%
231	Shpenzime kapitale	2,000	600	432	72%
	<b>TOTALI</b>	<b>75,728</b>	<b>76,835</b>	<b>76,666</b>	<b>99,8%</b>



**1. Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”,** buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2022, për këtë artikull është 66,128 mijë lekë, buxhet i cili do të mbulonte nevojat e institucionit në fushën e pagave për të gjithë vitin, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Gjatë këtij viti janë kryer pakësime dhe shtesa në artikujt buxhetorë nëpërmjet akteve normative në muajin prill dhe korrik dhe, për rrjedhojë, me qëllim mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore, janë kryer avancime të fondeve dhe rishpërndarje e tyre, me miratimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Siç u theksua dhe më sipër, gjatë vitit 2022, pagat e punonjësve të institucionit kanë pësuar ndryshime me vendimin nr. 37/2022 të Kuvendit të Shqipërisë. Sipas këtij vendimi, punonjësit e Njesisë Administrative kanë përfituar një shtesë prej 10%, për natyrë të veçantë pune, për disa punonjës administrativë u bë riklasifikim page, si dhe u përcaktua masa dhe kufiri maksimal i pagesave shtesë për shkak të vështirësisë, deri në 3 paga mujore në vit, për Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor.

Gjithashtu me VKM-në nr. 621, datë 28.9.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike’ ”, të ndryshuar, të gjithë punonjësit e Institucionit të Komisionerëve Publikë përfituan një rritje rreth 7% të nivelit të pagave.

Efektet financiare të këtyre vendimeve u mbuluan me alokimin e buxhetit shtesë në shpenzime personeli, me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.7.2022, dhe në vijim, gjatë muajit tetor, u alokua buxhet shtesë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në fund të vitit 2022, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 898, datë 29.12.2022, “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të Njesisë të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik, për zbutjen e impaktit të krizës”, fondet e lira në shpenzime korente u transferuan në artikullin 606, “Transferata te buxhetet familjare dhe individët”.

Në total, buxheti në shpenzime personeli pas rishikimeve arriti në vlerën 70,575 mijë lekë, duke mbuluar shpenzimet e personelit për 30 punonjës, bazuar në Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, të ndryshuar, si dhe për 2 punonjësit me kontratë të përkohshme. Performanca e realizimit të këtij buxheti për vitin 2022, paraqitur në formë tabelore dhe grafike, është rreth 100%.

**2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”,** buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull, për vitin 2022, ishte 7,400 mijë lekë dhe, pas rishikimit të buxhetit me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.3.2022, të Këshillit të Ministrave, dhe rialokimeve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, buxheti në shpenzime operative u pakësua me 2,840 mijë lekë, duke arritur në vlerën 4,760 mijë lekë. Rialokimet e buxhetit u kryen në kuadër të ekonomizimit të fondeve buxhetore, duke kryer rishpërndarje të tyre brenda shpenzimeve korente, duke përcaktuar prioritetet për plotësimin e nevojave më të domosdoshme dhe më emergjente për mallra dhe shërbime, dhe për të plotësuar nevojat në fushën e pagave pas ndryshimeve të dispozitave ligjore.

Fondet e lira në fund të vitit në këtë artikull buxhetor u transferuan në artikullin 606 dhe buxheti i rishikuar arriti në vlerën 3,728 mijë lekë, ndërsa performanca e realizimit të tij është rreth 100%.

Gjatë vitit 2022 janë kryer disa procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël, për materiale pastrimi, kancelari, tonera, bileta transporti ajror, si dhe me procedura të thjeshtuara, blerje materiale dhe shërbime, si: blerje karburanti, ujë i pijshëm, mirëmbajtje pajisje elektronike, mirëmbajtje e faqes *web*, mirëmbajtje dhe shpenzime larje automjeti, abonime në shtyp etj.

Gjithashtu janë kryer shpenzime nga buxheti për udhëtime jashtë vendit të përfaqësuesve të institucionit në takimet dypalëshe BE - Shqipëri, për Kapitullin 23, si dhe janë lidhur kontrata për parkim automjeti, telefoni celulare, si dhe shpenzime të zakonshme për energji, ujë, postë, taksa bashkie etj.

Në mënyrë analitike, shpenzimet operative janë realizuar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Në mijë lekë	
		602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	1,042	1,042
2	Shërbime nga të tretë (energji, ujë, postë, telefon, parkim etj.)	1,747	1,747
	Materiale dhe shërbime speciale	88	88
3	Shpenzime transporti + udhëtimi	579	579
4	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	130	130
5	Shpenzime të tjera speciale	142	142
	<b>TOTALI</b>	3,728	3,728

**3. Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”,** buxheti i miratuar për këtë artikull, për vitin 2022, ishte 2,000 mijë lekë, buxhet i cili tejkalonte kërkesën e institucionit, paraqitur kjo në dokumentin e

Projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2022-2024, kërkesë e cila u kushtëzua nga përfundimi i mandatit kushtetues të institucionit.

Gjatë këtij viti, duke vlerësuar plotësimin e nevojave më emergjente për pajisje dhe mobilie zyre, me rreth 600 mijë lekë, duke marrë në konsideratë jetëgjatësinë e aseteve dhe mandatin kushtetues të institucionit, u kërkuar rishikimi i buxhetit për vitin 2022 në shpenzime kapitale, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e pagave, i cili u realizua me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.7.2022, me 1,400 mijë lekë.

Me buxhetin në shpenzime kapitale pas rishikimit janë blerë orendi zyre, me procedurë blerje me vlerë të vogël, duke plotësuar kështu disa nga nevojat më emergjente.

Performanca e realizimit të buxhetit në “Shpenzime kapitale”, në bazë të analizës krahasimore plan-fakt, për vitin 2022, është në nivelin 72%.

Në përfundim, vlerësojmë se buxheti i vitit 2022 është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2022, duke arritur një performancë të lartë të realizimit të tyre, në të gjithë zërat e shpenzimeve, si dhe duke plotësuar nevojat më të domosdoshme për mallra dhe shërbime, për ecurinë e aktivitetit institucional.

**Nëpunës Zbatues**

Adelina Kastrati



**Nëpunës Autorizues**



Alketa Çeli



**ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"**

ne 000/leke


Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programet		Shpenzimet e Institucionit							
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitet paraardhes Viti 2021	(2) PBA Viti 2022	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 12 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
0001	Programi 03360	68,776	73,528	75,728	76,835	76,835	76,666	-169	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		68,776	73,528	75,728	76,835	76,835	76,666	-169	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		68,776	73,528	75,728	76,835	76,835	76,666	-169	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	15.2.2023		Data	15.2.2023

**ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"**

ne 000/leke


Emri i Grupit	Komisionerët Publikë						Kodi i Grupit	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik						Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2021	(2) PBA Plan 2022	(3) Buxheti Vjetor Viti Plan Fillestar viti korrent 2022	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 12 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5)  Diferenca
600	Paga	59,279	59,528	59,528	63,571	63,571	63,571	0
601	Sigurime Shoqërore	6,465	6,600	6,600	7,004	7,004	7,004	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,002	7,400	7,400	3,729	3,729	3,728	-1
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	30		200	1,931	1,931	1,931	0
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>68,776</b>	<b>73,528</b>	<b>73,728</b>	<b>76,235</b>	<b>76,235</b>	<b>76,234</b>	<b>-1</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	0		2,000	600	600	432	-168
232	Transferta Kapitale							0
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,000</b>	<b>600</b>	<b>600</b>	<b>432</b>	<b>-168</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,000</b>	<b>600</b>	<b>600</b>	<b>432</b>	<b>-168</b>
<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>							0	
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)</b>		<b>68,776</b>	<b>73,528</b>	<b>75,728</b>	<b>76,835</b>	<b>76,835</b>	<b>76,666</b>	<b>-169</b>


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	15.2.2023		Data	15.2.2023

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmbljedhes i realizimit të treguesve të performances/produkteve të programit"**

<b>Emri i Grupit</b>	Komisionerët Publikë	63
<b>Programi</b>	Veprimtaria e Komisionerit Publik	3360

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performances/Produktit	Njësia matëse	I			II			III			IV			Luhatjet në Koston për Njësi		
			Sasia Faktike (sipas vitit 2021)	Shpenzimet (sipas vitit 2021)	Kosto për Njësi (sipas vitit 2021)	Sasia (sipas planit të vitit 2022)	Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022)	Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit 2022)	Shpenzimet (sipas planit të rishikuar të vitit 2022)	Kosto për Njësi (sipas planit të rishikuar të vitit 2022)	Sasia Faktike për 12 muajorin e vitit 2022	Shpenzimet Faktike për 12 muajorin e vitit 2022	Kosto për Njësi për 12 muajorin e vitit 2022	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
Produkti 1	Numer Çështjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë brenda afatëve ligjore	nr. Çështjesh	171	68,776	402	160	73,728	461	160	76,235	476	109	76,234	699	74%	52%	47%
Produkti 2	Pajisje komp/mobilie/pajisje zyre	sete punë	5	0	0	9	2,000	222	9	600	67	7	432	62	#DIV/0!	-72%	-7%
	<b>Totali</b>			68,776	402	169	75,728	683	169	76,835	543	116	76,666	761			

<b>Nepunesi Zbatues</b>	Emri	Adelina Kastrati
	Firma	
	Data	15.2.2023



<b>Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues</b>	Emri	Alketa Çeli
	Firma	
	Data	15.2.2023



ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periudha e Raportimit: 12 mujori 2022



Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:						Komente
Qellimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise ka per qellim garantimin e e funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi	Veprimtaria e komisionerit Publik						
*Objektivat e politikës*:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2021	Niveli i planifikuar ne vitin 2022	Niveli i rishikuar per 12 mujorin e vitit 2022	Niveli faktik per 12 mujorin e vitit 2022	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te rregullt ligjor, transparences dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."							
	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	171	160	160	109	68%

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	15.2.2023		Data	15.2.2023

**ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"**

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2022	Realizimi Progresiv nga fillimi i vitit 2022	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progresiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	-				600	432	432		Pakesuar fondi ne investime me AN nr.12/2022. Realizuar procedura per rafte zyre.
M630013	Pajisje kompjuterike	-				-	-	-		Pakesuar fondi ne investime me AN nr.12/2022
<b>TOTALI</b>		-			-	<b>600</b>	<b>432</b>	<b>432</b>	-	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	15.2.2023		Data	15.2.2023